

Fjalimi i plotë i Kadaresë

“Është bërë pothuajse zakon që shkrimtari ose artisti, kur merr një çmim prestigjioz, në fillim të fjalës së rastit, në qoftë se të tillë do të ketë, të thotë diçka për çastin e parë kur e mori vesh lajmin.

Mendoj se nuk ka ndonjë arsye të veçantë për këtë. Thjesht është gjithmonë më e lehtë të fillosh në këtë mënyrë një fjalim. Dhe kështu ndodh që fituesi, duke nisur nga befasimi përfundon te modestia, shpesh e panevojshme. Kam përshtypjen se shkrimtari mund të befasohet ngaqë merr një çmim, po aq sa ç’mund të befasohet tjetri që nuk e merr.

Megjithatë, pa kërkuar të tregohem origjinal, po e pohoj sinqerisht se, kur më lajmëruan për çmimin “Jerusalem”, ndjesia e parë pas kënaqësisë, ka qenë ajo e surprizës. Befasimi lidhej me motivin e lirisë, që e kushtëzonte, si temë kryesore, këtë çmim. E dinin vallë zotërinjtë e jurisë që shkrimtari i laureuar, më saktë, vepra e tij, kishte një problem me lirinë?

Më duhet të pranoj se pyetja tingëllonte më shumë se naive. Unë isha shkrimtar, pra një murg i letërsisë, ndaj ishte e natyrshme të kisha një lidhje pozitive, harmonioze me lirinë. Problemi ishte thjesht i natyrës së rrokshme, bazike: po merrja një çmim të madh për lirinë në letërsi, në kohën që gjysma e veprës sime nuk ishte shkruar në liri, por në robëri (non libérté).

Pas rënies së komunizmit, për ne shkrimtarët që kishim jetuar në kohën e tij e tani po kalonim në një kohë tjetër, pyetjet dramatike tingëllonin shpesh naive, dhe e kundërta, naivet, ktheheshin në dramatike.

E tillë do të ishte, për shembull, pyetja se si do të quhej letërsia e kohës së totalitarizmit? Do të quhej ashtu siç ishte bërë zakon: letërsi e realizmit socialist, apo do të gjendej një tjetër emërtim? Dhe kryesorja: si do të vlerësohej ajo? Si diçka që kishte rënë bashkë me diktaturën? Si diçka e panevojshme, njëfarë nënletërsie, që do të kujtohej vetëm si kureshti?

Rrjedhimisht, pyetje të ngjashme do të shtroheshin për ne, shkrimtarët që kishim bërë letërsi në atë kohë të gabuar. Gjatë kohës së regjimit totalitar nuk besoj se ka pasur ndonjë shkrimtar që nuk ka bërë, qoftë dhe një herë të vetme, hamendësimin se si do të shkruante në qoftë se do të jetonte në liri? Hamendjet ishin të larmishme. Nga ata që ishin të sigurt se po të ishin të lirë do të shkruanin perla, gjer te shumica, e cila, duke mos shkuar gjer te perlat, mendonte se, sido që të vinte puna, diçka më të mirë do të bënin.

Ne nuk besonim se komunizmi do të binte në gjalljen tonë.

Dhe ja, mrekullia ndodhi. Komunizmi ra. Dhe ne u gjendëm në kohën tjetër. Një specie e veçantë shkrimtarësh, e huaj, e frikshme, ndoshta e panevojshme.

Tërheqja nga skena ishte mendimi i parë që vjen në kësi rastesh.

Kur një diktaturë bie, të shumtë janë ata që, duke bërë të habiturin, turren të shpjegojnë se si erdhi puna që kjo diktaturë e frikshme u vendos. Dhe kush ishin fajtorët për këtë.

Shkrimtarët shqiptarë u gjendën nën një stuhi qortimesh të llojit: më mirë të kishit heshtur se të shkruanit. Ose, të kishit rënë në burg. Për të mos thënë më të keqen: më mirë të kishit vdekur.

Më kot ngriheshin zërat për të sqaruar se një diktaturë nuk e sjellin dhe as nuk e rrëzojnë romanet dhe vjershat. Se të bësh letërsi nuk është mëkat. Se nuk është mëkat në asnjë vend. Dhe në asnjë kohë, sado e mbrapshtë të jetë ajo.

Bota perëndimore, e cila herë pas here ndiqte zhvillimet në Shqipëri, sidomos pas shkëputjes së saj groteske nga kampi socialist, kishte dhënë qartësisht shenjat se letërsia dhe artet shqiptare, ndonëse të rralla e të pakta, ishin i vetmi prodhim pak a shumë normal dhe pozitiv që jepte ky vend. Megjithatë, vlerësimi i asaj që quhej “botë e lirë” nuk luajti rolin që duhej në Shqipëri. Mendimi se letërsia shqipe e kohës së komunizmit duhej fshirë nga historia, zotëronte. Paralelisht me të zotëronte shpresa se tani, falë lirisë, do të krijohej vetvetiu një letërsi e paparë ndonjëherë. Për çudi, vetë shkrimtarët u përfshinë nga ky iluzion, nga kjo pritje e mrekullisë.

Por mrekullia vononte.

Gjersa një ditë ndodhi zbulimi i madh. Mrekullia po ndodhte në sytë tanë, por ne ishim të paaftë ta kapnim.

Mrekullia ishte vetë fakti që mrekullia e pritur nuk po ndodhte.

Që letërsia vazhdonte t’iu bindej ligjeve të saj. Që ajo ishte shpërfillëse ndaj kohës.

Që robëria nuk kishte fuqi ta prishte. Madje vetë liria, gjëja më sublime në botë, ishte e aftë të përmirësonte gjithçka, me përjashtim të letërsisë.

Shkurt, letërsia ishte e pavarur. Ajo mund të gjykohej vetëm sipas ligjeve të saj. Sipas këtyre ligjeve, përgjegjësinë për fatin e letërsisë e mbajnë shkrimtarët vetë. Ata nuk mund të justifikohen se bënë letërsi të keqe, ngaqë koha ishte e keqe. Ata nuk kanë alibi.

Në këtë pikë diskursi ngjitet vetvetiu në një nivel më të lartë. S’them ndonjë gjë të re po të kujtoj se kjo mospërputhje e ligjeve të shoqërisë njerëzore me ligjet e artit e ka zanafillën e saj qysh në fillimet e antikitetit, më saktë, të teatrit antik grek.

Sipas një përfytyrimi disi të thjeshtuar, viti i njeriut antik ndahej në tri periudha: E para, koha e veprimtarisë jetësore, ndërtuese. E dyta, koha e luftës. E treta, stina teatrale. Thënë shkurt, njerëzit, pasi ndërtonin e pastaj shkatërronin sa mundnin, ndienin nevojën të shkonin në teatër, për të parë atë që luhej në skenë.

Pyetja se çfarë kërkonin të shikonin spektatorët në teatër lidhej me thelbin e artit dhe arsyen e të qenit të tij. Për të gjetur përgjigjen, së pari duhet të kemi parasysh se qytetet antike ishin tepër të vogla, kurse teatrot tepër të mëdhenj. Rrjedhimisht, spektatorët përbënin një pjesë të madhe të popullsisë. Ata ishin njëherësh qytetarë, ushtarë, zyrtarë, zgjedhës, opinion publik. Ata i njihnin pamjet e jetës, ashtu siç njihnin ato të luftës. Por në skenë ata kërkonin diçka tjetër: pjesën e padukshme të botës, atë që ndodhte jo në sheshet e zhurmshme, por në thellësi të shpirtit njerëzor.

S’është e rastit që tragjedia fitoi qysh në krye vendin e zgjedhur, duke u kthyer në kurorë të artit antik. Ishte ajo e para që zbuloi atë që ngjante e pazbulueshme: shqyrtimin, vrasjen e ndërgjegjes.

Qytetërimi niste pikërisht aty.

Shqyrtimi i ndërgjegjes mbetet sot po aq dramatik dhe aktual sikurse në teatrin grek, dy mijë e pesëqind vite më parë. Nga krimet e nazizmit e të komunizmit, ai vjen gjer te hapja e dosjeve të fshehta, ato që janë kthyer në ankth në vendet që ende s'e kanë bërë këtë, duke përfshirë këtu, për fat të keq, edhe vendin tim, Shqipërinë.

S'është e rastit që kur shkojmë në Yad Vashem, këtu në Jerusalem, ne përpiqemi të kapim përmasat e një tmerri që gjuha njerëzore, duke pranuar kufizimet e saj, e ka përcaktuar si "të papërfytyrueshëm".

Letërsia, siç u tha, ka nisur si një kërkim i madh ndjese për një krim të madh të kohës: shfarosjen e një populli. Si e tillë, qysh në rreshtat e parë të saj, ajo ka kërkuar ndalimin e këtij tmerri.

Për fat të keq, kjo ende s'po ndodh. Thirrjet për shfarosje popujsh, që ju i njihni më frikshëm se kushdo, ende vazhdojnë. Megjithatë ne duhet të shpresojmë. Ndonëse jetojmë në një botë të ashpër, s'mund të themi se, midis mjegullës së saj, nuk kemi vënë re raste mirëkuptimi të madh. I tillë është pakti i popujve që, ndonëse e kanë aq lehtë të grinden për tokat, naftën, apo për një ishull të humbur, nuk grinden kurrë për vlerat shpirtërore, letërsinë dhe artet. Në ndryshim nga gjithçka tjetër, çdo popull i krijon këto vlera për veten e njëherësh për të tjerët. Asnjë shtet, sado i fortë të jetë, nuk ngre ushtrinë a flotën, se po i marrin Shekspirin a Moxartin. Dhe kjo histori ka nisur që nga Roma e Virgjilit, për të ardhur gjer te Rusia e sotme, që kacafytet për ca kufij në Ukrainë, pa u bërë merak se qyshkur ia kanë marrë e vazhdojnë t'ia marrin Tolstoin.

Ky zakon befases dëshmon se njerëzimi, sa ç'është i aftë për keqkuptime, po aq e ka të mundur mirëkuptimin.

Më lejoni të zgjatem me një shembull nga Gadishulli Ballkanik, të cilit i përkas. Ky rajon i Europës është shquar gjithmonë për grindje dhe acarim. Shqiptarët, ashtu si të tjerët, janë gjendur në qendër të një rivaliteti dhe mosmarrëveshjeje për gjithçka.

Ndërkaq, ka kohë që në Ballkan është shfaqur një rivalitet i ri, që lidhet me hebrenjtë. Më saktë, me mbrojtjen e hebrenjve gjatë luftës.

Prej shumë kohësh shqiptarët ngulin këmbë se është vërtetuar që në mbarim të luftës, ndërsa në gjithë Europën hebrenjtë ishin rralluar krejt, si pasojë e gjenocidit, në Shqipëri përkundrazi, ishin shtuar dukshëm. Arsyeja ishte e thjeshtë: hebrenjtë, që nga dita e parë e luftës gjer në të fundit ishin të mbrojtur në Shqipëri.

Popuj të tjerë në Ballkan dëshmojnë gjithashtu mbrojtjen e hebrenjve prej tyre. Është krejtësisht e huaj për mua ideja që, duke përfituar nga prania në këtë sallë, të bëhem pjesë e këtij të ashtuquajtur rivalitet. Dëshiroj vetëm të them me përgjegjësi të plotë morale, se mëtimi (pretendimi) i kahershëm shqiptar është krejtësisht i drejtë. Por kjo s'do të thotë aspak se kam rezervën më të vogël për mëtimin e të tjerëve.

Jo vetëm kaq. Duke njohur natyrën e vështirë të popujve ballkanas, brezat më të rinj, që hyjnë në jetë në gadishull, ëndërrojnë natyrshëm të sjellin një frymë të re, të ndryshme dhe pajtuese.

Në këtë kah (sens), sa herë që bie fjala për të krahasuar aktet e popujve tanë, mungesat dhe meritat, vetvetiu krijohet një atmosferë e rënduar, ku xhelozia dhe rivaliteti sundojnë mbi gjithçka.

Do të ishte një gjë e rrallë që mbrojtja e hebrenjve, për të cilën u fol më lart, të bëhej shkas për një vizion të ri, afrues e pozitiv.

Bota ka nevojë për këtë vizion. Popujt kanë gjithmonë nevojë të mbrohen. Duke mbrojtur të tjerët, ata mbrojnë veten.

Do të doja që me një urim të tillë ta mbyllja këtë diskurs për lirinë, këtu në Jerusalem.

ISMAIL KADARE